Date __/ 08/ 2021

NJOFTIM

Drejtuar : Agjencise Kombetare te Mjedisit

Lenda: Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun

Shoqeria "GAMASERVICE" Sh.p.k njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit B per instalimin:

Menaxhimi i mbetjeve. ID 5.3 a. Asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme pervec incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2 a) - Kapaciteti kufi per lejet e tipit B; ID 5.10 a. Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme qe nuk permendet me lart - Kapaciteti kufi per lejet e tipit B dhe ID 5.10 b. Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme qe nuk permendet me lart - Kapaciteti kufi per lejet e tipit B, me vendndodhje Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK 2679, Numri i pasurise 11/24, Mezez, Kashar, Tirane.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014 , Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar, kreu VI "Informimi dhe pjesemarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B", bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për "**Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B**" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B".
b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
e) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
f) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
g) Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
h) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
i) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit

a. Kerkesa per vendosjen ne funksionim te instalimit "Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme" eshte per aplikim **per leje te re mjedisore te tipi B**, sipas Shtojces 1, te Ligjit Nr. 52/2020 date 30.04.2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, date 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar, Menaxhimi i mbetjeve

- ID 5.3 a. Asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme pervec incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2 a);
- ID 5.10 a. Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme qe nuk permendet me lart dhe
- ID 5.10 b. Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme qe nuk permendet me lart".

b. TE DHENAT E EKSTRAKTIT TE QKB-SE

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M01425024N	
2. Data e Regjistrimit	25/02/2020	
3. Emri i Subjektit	GAMASERVICE	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	24/02/2020	
6. Kohëzgjatja	Nga: 24/02/202024/02/2050	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kashar MEZEZ Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK2679, Numri i pasurise 11/24, Vol8, Fq 179	
8. Kapitali	1.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Konsulence dhe sherbime per strukturat spitalore si dhe furnizime pajisjesh dhe produktesh mjekesore . Transport mbetjesh te rrezikshme spitalore . Dhenie me qera te mjeteve te transportit dhe aktiveve te tjera te shoqerise, si dhe ushtrim i cdo aktiviteti tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne funksion te realizimit te objektit te veprimtarise.	
10. Administratori/ët	Artan Lleshi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 24/02/2020	Deri: 24/02/2025
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	ArtanLleshi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 1.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		

Kopje nga web

1

c. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

<table>
<tr><td>Emri i instalimit/impiantit[1]</td><td>Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme</td></tr>
<tr><td>Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianti</td><td>Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK 2679, Numri i pasurise 11/24, Mezez, Kashar, Tirane</td></tr>
<tr><td>Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4
 
</td><td><table><tr><th colspan="3">Koordinatat ku zhvillohet aktiviteti</th></tr><tr><th>Nr</th><th>X</th><th>Y</th></tr><tr><td>1</td><td>4580368.64</td><td>4395621.14</td></tr><tr><td>2</td><td>4580357.91</td><td>4395616.82</td></tr><tr><td>3</td><td>4580364.98</td><td>4395598.69</td></tr><tr><td>4</td><td>4580375.85</td><td>4395603.16</td></tr></table></td></tr>
<tr><td>Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi [2]</td><td>ID 5.3 a. Asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme pervec incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2 a);
ID 5.10 a. Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme qe nuk permendet me lart dhe
ID 5.10 b. Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme qe nuk permendet me lart.</td></tr>
<tr><td>Kapaciteti i projektuar</td><td>Kapaciteti i asgjesimit te mbetjeve spitalore eshte 30 kg/ore

Kapaciteti i projektuar i stacionit te transferimit te mbetjeve spitalore te rrezikshme (perprara se ti nenshtrohen procesit te sterilizimit) eshte deri ne 15 ton/dite

Kapaciteti i projektuar i stacionit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme (pas procesit te trajtimit) eshte me i madh se 50 ton/dite</td></tr>
</table>

[1] Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

[2] Shkruani kodet e specifikuara në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuara në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET

AKTIVITETI: Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme

Adresa: Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK 2679, Numri i pasurise 11/24, Mezez, Kashar, Tirane

Subjekti: "**GAMASERVICE**" Sh.p.k

Administrator: Z. Artan Lleshi

- **Hyrje**

Profili i shoqërisë "GAMASERVICE" Sh.p.k

Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme të shoqërisë **"GAMASERVICE" shpk** është i pozicionuar ne Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK 2679, Numri i pasurise 11/24, Mezez, Kashar, Tirane. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin e asgjesimit te mbetjeve spitalore dhe menaxhimin e integruar te mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, me nr. NUIS: **M01425024N**. Siperfaqja ku ushtrohet veprimtaria eshte marre me qira e cila ploteson kushtet teknike dhe hapesirat e nevojshme

per ushtrimin e veprimtarise per Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme.

Informacion mbi kompanine "GAMASERVICE" sh.p.k

Shoqeria **"GAMASERVICE" sh.p.k** eshte nje subjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme. Qellimi i firmes ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj.

Per kete qellim, subjekti **"GAMASERVICE" sh.p.k** referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar ka plotesuar Formularit e Kerkeses per tu pajisur me Leje Mjedisi te Tipit B per aktivitetin Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, me vendndodhje ne Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK 2679, Numri i pasurise 11/24, Mezez, Kashar, Tirane. Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti ne fushen e menaxhimit te integruar te mbetjeve.

Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj, ne zonen ne studim eshte perqendruar nje numer i madh i bizneseve me karakter industrial, kryesisht ne fushen e tregetimit te karburanteve, prodhimin e pajisjeve dhe makinerive, serviseve te riparimit dhe lyerjes se automjeteve, tregetimin e pllakave dhe hidrosanitareve, etj.

Aktiviteti per asgjesimin e mbetjeve zhvillohet brenda objektit te tipit kapanon i cili ploteson te gjitha hapesirat e nevojshme per ushtrimin e veprimtarise

Qellimi i aktivitetit eshte ane te makinerise Newster NW10 e cila do te trajtoje mbetjet spitalore duke i sterilizuar ato dhe duke i perpunuar ne mase te grire e te presuar te cilat mund te dergohen per riciklim. Transferimin e mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe mbetjeve jo te rrezikshme qe dalin nga procesi i sterilizimit, duke reduktuar impaktin mjedisore dhe rrezikun e infeksioneve/epidemive qe shkaktohen nga mos trajtimi i i mbetjeve spitalore.

Aktiviteti zhvillohet ne nje ambjent te pershtatshem per kete aktivitet duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth.
Vendosja e Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj.

Brenda siperfaqes se veprimtarise jane te vendosura:

- Ambienti i sterilizuesit Newster NW10
- Ambienti per ruajtjen/magazinimin e mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme spitalore para se ti nenshtrohen procesit te sterilizimit
- Ambienti per ruajtjen/magazinimin e mbetjeve jo te rrezikshme pas trajtimit ne sterilizuesin Newster NW10
- Ambienti i ruajtjes/magazinimit te kontenierеve te mbetjeve spitalore perpara se te perdoren
- Ambienti i zyrave dhe ambienti higjenosanitar
- Sheshi per parkimin e automjeteve
- Sistemi i mbrojtjes nga sjarri

Gjithashtu ne kete ambjent bejne pjese edhe hapesirat per levizjen e mjeteve, njerezve dhe siperfaqet e gjelbera, oborri i cili eshte i gjelberuar anash me bimesine karakteristike te ketyre ambjenteve.

- **Të dhëna mbi impiantin e instaluar**

Shoqëria **“GAMASERVICE” shpk** si firmë me aktivitet në fushën e veprimtarisë Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, ka investuar dhe disponon impiantet/makineritë e domosdoshme për zhvillim e proceseve kryesore.

- **Karakteristikat e makinerise Newster NW10**

NEWSTER® NW10

Sterilizues per mbetje spitalore infektive

Te dhena teknike

Metoda e sterilizimit	Ngrohje me ferkim (Nxehtesi e lagesht e papresionuar)
Kapaciteti i trajtimit	30 kg/h (320 lt/h)
Aspekti i jashtem i mbetjeve te trajtuara	Grimca te vogla homogjene
Vellimi perfundimtar i mbetjes se trajtuar	20-25% e vellimit fillestar
Pesha perfundimtare e mbetjes se trajtuar	70-75 % e peshes fillestare
Vellimi i enes se sterilizimit	rreth 150 litra Ø=500 mm, H=776 mm
Sistemi i kontrollit te pergjithshem	Kontrollues logjik i programueshem (PLC)
Matja e temperatures	Me sensore me rezistence variabel
Regjistrimi i ciklit	Rregjistrimi i luhatjes se temperatures ne kohe
Regjistrimi perfundimtar	Rreth 95 °C nepermjet avullimit te H2O
Ulja e pluhurit	Ne ambient te lagesht.
Mbyllja e kapakut	Manual, bllokim mekanik dhe pajisje e dyfishte sigurie
Pajisjet e sigurise	Sistemi bllokues mekanik i kapakut te enes se sterilizimit, furnizimi me energji ne motorin kryesor eshte nderprere ne rast te deshtimit te bllokimit te kapakut. Komandat e tensionit te ulet dhe paneli i kontrollit me nderprerje automatike te energjise nese panelet jane te hapura. sistemi i ngrohjes se rezistences elektrike qe do te perdoret ne rast te ndalimit te emergjences
Tehe rrotulluese dhe kundertehe fikse	Perbehet nga aliazhe metali
Konsumi i H2O	Rreth 70 lt/dite me sistem riciklimi uji Afersisht 50 lt / ditë me sistemin e riciklimit të ujit (opsional)
Shkarkimi i ujit	Tub kanalizimesh me diametër 40 mm
Konsumi i pergjithshem i energjise	maksimumi 30 kW mesatarisht 18 kW/ orë
Permasat dhe pesha e sterilizuesit	80 x 160 x 150 cm
Grupi i Filtrit	80 x 35 x 150 cm
Paneli elektrik	50 x 80 x 160 cm
Pesha totale	980 kg

- **STACION TRANSFERIMI PER MBETJE TE RREZIKSHME DHE JO TE RREZIKSHME**

Stacioni i transferimit per mbetjet e rrezikshme eshte nje infrastrukture ndihmese per proceset e asgjesimit te mbetjeve spitalore, i cili konsiston ne ruajtjen e perkohshme te mbetjeve ne pritje te operacioneve me ane te asgjesimit me ane te Autoklaves Newster NW10.
Shoqeria GAMASERVICE e cila operon ne fushen e asgjesimit dhe transferimit te mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme referuar Ligjit Nr. 10 463, date 22.09.2011 "Per Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve" i ndryshuar operacionet qe do te perdore jane:
D15, R12 dhe R13

Per vendosjen ne funksionim te instalimit per transferimin e mbetjeve spitalore do te ndiqen hapat e meposhtem:

1. Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve spitalore nga qendrat e gjenerimit te tyre (spitale, ambulanca, poliklinika, qendra te trajtimit dentar dhe shendetesore, qendrat e kujdesit te kafsheve, nga konsumatoret e qendrave urbane) me ane te mjeteve teknologjike te posacme (furgona te mbyllur dhe te pajisur me kodin e ADR-se per substancat e rrezikshme).

2. Mbetjet spitalore do te transportohen nga burimi i gjenerimit te tyre per ne stacionin e transferimit te mbetjeve, ku do te shkarkohen sipas procedures per Administrimin e Mbetjeve Spitalore

3. Pasi mbetjet spitalore jane shkarkuar ne brendesi te objektit ku ushtrohet veprimtaria, mund ti nenshtrohen procedures se asgjesimit me autoklaven Newster NW10, ose sistemohen brenda objektit ne pritje te procedures se asgjesimit me autoklava (ne rastet kur makineria Newster NW10 eshte ne pune).

Shenim: Stacioni i transferimit te mbetjeve spitalore nevojitet per ruajtjen e perkohshme te mbetjeve, ne pritje te operacioneve te asgjesimit me ane te autoklaves Newster NW10, kjo ndodh kur keto dy instalime jane ne funksionim dhe per arsyet te zbatimit te ligjit per menaxhimin e integruar te mbetjeve dhe rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore, nevojitet nje ambient i cili ploteson kushtet higjeno-sanitare dhe mjedisore, per ruajtjen e perkohshme te mbetjeve, deri ne momentin e asgjesimit perfundimtar te tyre nga instalimet e shoqerise GAMASERVICE Sh.p.k.

Stacioni i transferimi te mbetjeve te rrezikshme eshte reparti i pare per asgjesimin e mbetjeve spitalore me metoden e Newster NW10, ku mbetjet shkarkohen nga mjetet e transportit, magazinohen/ruhen perkohesisht dhe me pas nepermjet komunikimit te brendshem, mbetjet dergohen ne repartin ku eshte instaluar makineria Newster NW10.

Nga ketu mbetjet sterile, te trajtuar ne makinerine Newster NW10, te cilat jane 70-75% peshes totale, mund te dergohen direkt ne Lendfillin e Mbetjeve Urbane te qarkut perkates, ose mund te magazinohen/ruhen perkohesisht ne ambientet e shoqerise deri ne plotesimin e sasise se transportit nga mjetet e transportit te mbetjeve. Reparti i stacionit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme komunikon me repartin ku eshte instaluar makineria Newster NW10.
Te gjitha repartet e asgjesimit te mbetjeve spitalore infektive, kane komunikim me njeri tjetrin dhe jane lehtesisht te aksesueshem nga punonjesit dhe mjetet e transportit nga 2 drejtime kryesore.
E gjithe procedura per grumbullimin, transportimin dhe transferimin e mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme qe vijne nga qendrat e kujdesit shendetesor ne territorine Shqiperise, do te kryhet nepermjet faturave tatimore/marreveshjeve kontraktuale dhe dokumentave per transferimin e mbetjeve te ketij tipi, sipas kodeve perkatese referuar Vendimit Nr. 371, date 11.06.2014 "Per miratimin

e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te dokumentave te dorezimit te tyre" te ndryshuar dhe Vendimit Nr. 229, date 23.04.2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe informacionit qe duhet te perfshihet ne dokumentin e transferimit" te ndryshuar.

- **Koncepti i stacionit te transferimit**

Stacioni i transferimit konsiston në marrjen e mbetjeve nga gjeneruesi dhe ruajtjen/magazinimin e tyre përkohësisht në stacionin e transferimit dhe më pas transportimin e tyre drejt operatorëve të licencuar për trajtimin, rikuperimin, lendfillimin, asgjësimin dhe/ose incinerimin përfundimtar të këtyre mbetjeve.
Ne rastin konktet per aktivitetin e shoqerise GAMASERVICE nuk do te kemi transferim te mbetjeve spitalore drejt operatoreve te tjere, por procedura e asgjesimit do te kryhet po nga kjo shoqeri me ane te instalimeve te Autoklaves Newster NW10.



Në këto kushte gjen zbatim një nga parimet bazë të ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, parimi i riparimit të dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit të mjedisit të dëmtuar, pra me qëllimin kryesor largimin e mbetjeve spitalore të rrezikshme dhe jo të rrezikshme nga gjeneruesi i tyre, grumbullimin, transportimin dhe transferimin në stacionin e transferimit duke mundësuar asgjësimin përfundimtar të tyre po nga shoqeria GAMASERVICE.

- **Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit dhe siguria në punë**

Projekti duke u mbështetur në analizën e rreziqeve nga zjarri ka zgjidhur planimetrinë e përgjithëshme duke përcaktuar pozicionin e instalimeve, të rrugëve e të furnizimit me energji elektrike në mënyrë që këto të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit kundra zjarrit. Gjithashtu janë marrë masa mbrojtëse kundra zjarrit për ndërtesat në varësi nga shkalla e rrezikut si dhe në strukturat e zhvillimit te operacioneve dhe të magazinimit në mënyrë që të shmanget rënia e zjarrit ose përhapja e tij.
Në stacionin e pompave të ujit eshte vendosur dhe pompa e dedikuar për sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit. Janë parashikuar fikse zjarri për çdo ambient te ushtrimit te aktivitetit sipas shkallës së rrezikshmërisë. Gjithashtu në organizimin e punës janë parashikuar cikel trajnimesh per punonjesit per perballimin dhe menaxhimin e emergjencave qe mund te lindin gjate zhvillimit te veprimtarise.
Për mjedisin ku eshte instaluar autoklava Newster NW10 janë parashikuar dhe instaluar fiksa me CO_2 si dhe dedektorë alarmi kundër zjarrit.

Gjithashtu fasilitetet lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë janë në përputhje me kërkesat ligjore në këtë fushë. Janë parashikuar masa mbrojtës përkatëse për të realizuar sigurinë e nevojshme në punë si dhe sigurinë në procesin e asgjesimit.

- **Ndërtimi i linjës elektrike**

Në varësi të llojit të makinerive/pajisjeve dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrejti i shpërndarjes së energjisë elektrike eshtë në gjëndje mjaft të mire dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Objekti dhe instalimet/pajisjet per asgjesimin e mbetjeve infektive spitalore në të gjitha ambjentet e tyre jane pajisur me kaseta të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe drejtohen nga paneli i kontrollit per secilin proces pune.

- **Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brëndshme**

Objekti lidhet me rrugen dytesore Vore-Tirane, nepermjet infrastruktures se brendshme, cka ben te mundur qe ky objekt te mos ndikoje ne trafikun e zones. Rruga e cila të dërgon në hyrje të objektit është ekzistuese dhe në gjendje mjaft të mire e shtruar me asfalt dhe e niveluar sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke mundesuar levizjen e lire te mjeteve. Gjithashtu pergjate gjithe gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Planvendosja e impiantit e paraqitur në ortofoto.

Në afërsi të zonës ku zhvillon aktivitetin subjekti "**GAMASERVICE**" nuk ka shkolla, vepra arti, argjinatura, linjë elektrike të tensionit të lartë dhe linjë uji që mund të dëmtohen nga zhvillimi i aktivitetit për **"Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme".**

e. PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- **INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;**

Menaxhimi i mbetjeve. ID 5.3 a. Asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme pervec incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2 a) - Kapaciteti kufi per lejet e tipit B; ID 5.10 a. Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme qe nuk permendet me lart - Kapaciteti kufi per lejet e tipit B dhe ID 5.10 b. Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme qe nuk permendet me lart - Kapaciteti kufi per lejet e tipit B.

- **LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;**

Duke patur asgjesues, lendet e para do te jene mbetje spitalore. Si lende e pare ndihmese mund te permendim energjine elektrike per vendosjen ne funksionim te sterilizuesit dhe uji qe sherben per ftohjen e mbetjeve pas trajtimit te tyre ne autoklave. Ambalazhet (kontenieret plastic dhe te kartonit) te cilat sherbejne per administrimin e mbetjeve spitalore, sigurohen nga importit, te cilat jane te prodhuar posacerist per mbetjet spitalore, shoqeruara me etiketat perkatese sipas tipit te mbetjes spitalore (shkalla e rrezikshmerise).

- **BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI;**

Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	A1
Burimi i shkarkimit	Autoklavat Newster NW10
Përshkrimi	Gjate procesit te te shkarkimit te mbetjeve nga autoklavat (avujt e ujit)
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	X: 4580363.16 Y: 4395603.38
Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m)	Nuk ka oxhak te instaluar pas sasia e shkarkimit eshte shum e vogel, duke qene se avujt e ujit me pare i nenshtrohen procesit te kondensimit, duke i kthyer ato ne uje dhe rikuperimin e tyre nga autoklava
Data e fillimit të shkarkimeve	Me miratimin nga Ministria e Mjedisit të Lejes së Mjedisit

Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve (një faqe për çdo pikë të shkarkimeve)

Nr. Ref. i pikës së shkarkimit: (numri i referencës duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit)	K1
Vendndodhja e pikës së shkarkimit rrjetin e kanalizimeve	Ne brendesi te territorit ku zhvillohet aktiviteti. Ujerat sanitare dhe te larjes
Koordinatat (për efekt të vlerësimit të ndikimit)	X : 4580367.42 Y : 4395598.25
Emri i kompanisë e cila menaxhon sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura	**GAMASERVICE**
A është sistemi i kanalizimeve i lidhur me një impiant trajtimi?	Impianti i trajtimit te ujerave te ndotura urbane
Emri i mjedisit përfundimtar ujor pritës të ujërave të ndotura nga rrjeti i kanalizimit (estuar, lumë ose mjedis tjetër ujor pritës dhe ndikimi në të i cili duhet kontrolluar)	Rrjeti i kanalizimeve te zones

Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

Burimi i shkarkimit	**Nr. Ref. i pikës së shkarkimit**	**Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4**	**Nr. Ref. i pajisjes që gjeneron ndotje aklustike**	**Presioni akustik[1] (dBA) duke ju referuar distancës**	**Periudha e shkarkimit**
Hyrje	1	X: 4580367.38 Y: 4395625.69		60	Gjate proceseve te furnizimit
Zona e trajtimit te mbetjeve	2	X: 4580365.76 Y: 4395608.17		55	Gjate proceseve te furnizimit

- **KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES;**

Zona ku do te zhvillohet aktiviteti Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, ndodhet ne Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK 2679, Numri i pasurise 11/24, Mezez, Kashar, Tirane.

Ne kete zone jane te perqendruar nje numer i konsiderueshem i subjekteve qe operojne ne fushen e tregetimit te karburanteve, prodhimin e mobiljeve, riparimin e mjeteve dhe lyerjen e tyre, tregetimin e pllakave, prodhimin e makinerive te ndryshme, etj.

- **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE**

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.
Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive te impiantit te asgjesimit te mbetjeve spitalore – sterilizimi (autoklave). Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.
Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete formular per pajisjen me leje mjedisi tipi B. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit
Shkarkime ne uje
Shkarkimet kryesore ne mjedis nga ujerat e ketij aktiviteti jane Shkarkimet ne kanalizime te ujerave higjieno-sanitare nga ambjentet e tualeteve dhe larja e ambjenteve te punes, kryesisht nga aktiviteti human. Duke qene mbetje te ambalazhuara, ujerat e larjes se ambjentit nuk rezultojne te jene te kontaminuara, por pavaresisht kesaj, subjekti kur kryen pastrimin e ambjentit, aplikon hipoklorit me qellim sigurimin e nje shkalle te larte steriliteti. Pra ne ujerat e larjes ambjenteve permbajtja e vetme vec ujit do te jete klori qe perdoret per pastrim, si ai i ambjenteve urbane perdorim shtepiak.

Shkarkimet e ujerave te zeza dhe higjieno-sanitare, jane lidhur me sistemin ekzistues te kanalizimeve te zones. Keto ujera do te shkarkohen ne kanalizime vetem pasi te jete provuar se jane brenda normave te lejuara me ligj. Ne baze te pajisjeve qe disponojme, nuk ka shkarkime te ujerave teknologjike. Materiali trajtohet ne te thate, uji I sistemit ftohes te pajisjes, me qellim kontrollimin e temperatures dhe ruajtjen e saj konstante, eshte sistem i mbyllur dhe me riqarkullim (parimi i sistemit ftohes tek motorret me djegie te brendshme te automjeteve). Ndersa avulli i cili prodhohet nga injektimi i ujit ne fund te procesit me qellim uljen e temperatures se mbetjes ne dalje ne temperature 95^{o}C, kalon nepermjet kondeses (tip kondesatori) dhe perfundon ne nje depozite uji me kapacitet rreth 1000 litra, e cila e rifut kete uje ne procesin tjeter. Keto ujera, trajtohen me hipoklorit, me qellim sigurimin e sterilizimit te mbetjes pas trajtimit nga Newster NW10. Pastrimi ose shkarkimi i depozites kryhet nje here ne jave ose nje here ne dy jave, ne baze te perdorimit te pajisjes.

Emetimet ne ajer

Emetime ne ajer nga funksionimi i ketij aktiviteti nuk do te kete. Nuk do te kete oxhaqe, perdorim te lendeve djegese, nuk ka procese me prodhim energjie. Makinerite funksionojne te gjitha me energji elektrike. Ngarkesa mikrobiale e mundshme nga keq menaxhimi ose avarite me mbetjet e pa trajtuara te cilat mund te perhapen ne mjediset e punes, eshte lehtesisht e zgjidhshme nepermjet metodave te sterilizimit te ajrit me pajisje perkatese. Keto efekte nuk jane prezente ne kushte normale te punes, vetem ne ndonje rast avarie. Punonjesit jane te pajisur te gjithe me mjete mbrojtese te tilla si: maska te thjeshta dhe me firba karboni, kapele, syze, kufje, doreza te pa depertueshme nga instrumentat e mprehta, kostum pune, cizme, xhupa etj. Demtim i punonjesve mund te vij vetem nga papergjegjshmeria individuale dhe e drejtuesit teknik.

Keto ndikime, ne te gjitha rastet ngelen brenda ambjenteve te punes dhe nuk jane problem per banoret e zones apo objektet fqinje. Nuk ka ndikime ne zonen perreth.

Zhurmat dhe vibrimet

Emetime te zhurmave nga funksionimi i ketij objekti do te kete vetem ne brendesi te kapanonit. Niveli i zhurmes do te matet pasi makinerite te jene instaluar dhe te vihen ne funksion. Nuk jane zhurma ne nivele te larta, por ne nivele normale ne ambjente pune.

Mbetjet e prodhuara

Ky aktivitet shoqerohet me gjenerim te mbetjeve te ngurta te cilat jane te ricikluesshme dhe do te lidhen kontrata me kompanite ricikluese te plastikes dhe metalit. Mbetjet e ngurta te sterilizuara rekomandohen te paketohen etiketohen dhe te dergohen per riciklim ne qendrat e riciklimit, ose ne Landfill per asgjesim.

Mbetjet e ngurta pas trajtimit, aktualisht dergohen per trajtim te metejshem te integruar ne landfillin e Tiranes, ku ne vazhdimesi do te dergohen ne Incineratorin e Elbasanit, ose landfillin e rajonit. Te gjitha keto levizje te mbetjeve jane aktualisht dhe do te vazhdojne te jene te dokumentuara dhe bazuar mbi kontratat dhe lejet perkatese te secilit operator. Mbetja qe del pas trajtimit eshte plotesisht e djegshme si lende djegese dytesore. Ne rast se nuk perdoret dhe nuk ka interes per ta marre si lende djegese atehere do te shkoje ne landfill per asgjesim me depozitim nentoke.

Ndikime te tjera ne mjedis

Ky aktivitet ne teresine e tij eshte me efekte positive ne mjedis dhe shendet. Trajtimi i ketyre mbetjeve qe kerkojne trajtim te vecante, eshte nje e mire mjedisore. Vete teknologjia e aplikuar dhe standarti i perdorur, bejne qe ndikimet e aktivitetit te jene fare minimale, drejt zeros. Nuk ka shkarkime ndotese ne mjedis, nuk ka emetim te lendeve ozonholluese, nuk ka prodhim te mbetjeve te rrezikshme, nuk ka ndotje te tokes. Mundeson reduktimin e volumit, peshes dhe rrezikut qe paraqesin mbetjet e prodhuara nga kujdesi shendetesor .

Ndikimi social-ekonomik i aktivitetit

Ndikimi social-ekonomik i ketij aktiviteti eshte vetem me efekte pozitive. Kjo pasi ky aktivitet nuk do te ndikoje negativisht as ne toke, as ne ajer as ne ujera, as ne mjedisin biologjik, si dhe nuk do te cenoje popullsine. Trajtimi i mbetjeve spitalore, duke eleminuar plotesisht rrezikun qe paraqesin per infeksionet, eshte nje ndikim pozitiv social. Duke sjelle ne memorje se deri para pak vitesh me mbetjet spitalore eshte abuzuar mjaft, ne kurriz dhe ne dem te popullsise, sot ky abuzim eshte minimizuar duke shkuar drejt zeros. Ne kete aktivitet jane te punesuar disa persona dhe ne te ardhmen eshte projektuar qe te shtohet numri i punonjesve qe do te perfshihen ne kete aktivitet.

Informacion për shkarkimet në mjedis.
Shkarkimet ne mjedis te ketij aktiviteti jane:

1. Shkarkime ne ujera nga procesi i ftohjes se materialit ne brendesi te autoklaves
2. Gjenerim te mbetjeve te ngurta te cilat jane te ricikluesshme dhe do te lidhen kontrata me kompanite ricikluese te plastikes dhe metalit.
3. Gjenerim i zhurmes vetem ne ambjentin e punes.
4. Ndotje e mjeteve te transportit dhe te punes.

Uji qe do te shkarkohet nga pajisja e sterilitimit te mbetjeve spitalore sipas patentes se pajisjes eshte uje i cili ruan parametrat e lejuara te ndotjes se mjedisit ujor prites. Mbetjet spitalore kalojne ne temperature 150 grade celsius tepmerature e cila shperben plotesisht bakteret dhe viruset qe mund te ndodhen ne mbetje.

- **TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME;**

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

	Rekomandime për zbutjen e ndikimeve
	Toka
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
	Biodiversiteti
Vegjetacioni **Dëmtim potencial i vegjetacionit**	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve te rinj, pergjate rruges qe ben te mundur hyrjen per ne objekt. Menaxhimi dhe administrimi i mbetjeve spitalore, sipas kushteve dhe standarteve kombetare dhe nderkombetare.
	Cilësia e ajrit
Shkarkimet ne ajer nga avujt e autoklaves	Autoklava eshte e pajisur me nje sistem filtrash, te cilet sherbejne per kapjen e avujve te ujit qe gjenerohen nga procesi i sterilizimit te mbetjeve spitalore.
	Sistemi i drenazhimit
Sistemi i drenazhimit	Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave te pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, shkarkimi i tyre brenda normave te lejuara ne rrjetin e kanalizimeve te zones.
	Zhurmat
Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti/ instalimet dhe nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i instalimeve brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.

	Trafiku rrugor	
	Trafiku Rrugor **Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve**	Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

- Ndjekja e gjithe kerkesave ligjore per venine ne funksion te aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve te treta.
- Aktiviteti kryesisht do te zhvillohet ne ambjent te mbyllur keshtu qe nuk do kete nivele zhurmash domethenese per zonen perreth. Do te behet pajisja e punonjesve me mjete mbrojtese personale.
- Kompania ka ndertuar sistemin per riperdorimin e ujrave te ftohjes dhe krijimin e nje cikli te mbyllur.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen te kete ndikime ne ndryshimin e habitateve
- Nuk kemi gjenerimin e Mbetjeve te rrezikshme, pasi mbetjet sterilizohen ato jane te pademshme.
- Mbetjet e gjeneruara nga punjonjesit do te grumbullohen ne konteniere te vecante. Kontenieret do te zbrazen rregullisht dhe mbetjet do te hidhen ne vendin e percaktuar nga Njesia Vendore per mbetjet urbane.
- Do te ndiqen gjithe rregullat e sigurimit teknik ne pune si dhe pajisjes se punonjesve me uniformat dhe mjetet e nevojshme te mbrojtjes ne pune.

Per me teper rekomandimet per te parandaluar dhe kontrolluar rrezikun e ndotjes perfshijme:

- Mbetjet urbane te paperdorshme te grumbullohen transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara nga Njesia Vendore.
- Te realiziohet ndriçimi perreth(vendosja e impiantit te ndricimit).
- Te kryhet rregullimi i territorit ne perputhje me kondicionet urbane te percaktuara.
- Shoqeria te operoje ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi, dhe te kryej monitorime te vazhdueshme te tregueseve mjedisor te trysnise ne mjedis.
- Te respektoje te gjitha rregullat e mbrojtjes kundra zjarrit gjate operimit ne ndertese dhe te respektoje rregulloren e MKZ.
- Te instalohen dhe te respektohen sinjalistikat e trafikut te cilat do te minimizonin impakti per aksidente te mundshme.
- Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme,
- Te respektoje te gjitha masat e percaktuara ne kete Formular Kerkese per tu paisur me Leje Mjedisi Tipi B.
- Te respektoje te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e pritshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithe perparesite qe ka ky aktivitet, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- Parandalimi i shkarkimeve te mbetjeve spitalore ne mjedis, administrimi sipas rregullove perkatese.
- Lidhur me mbetjet e gjeneruara nga procesi i sterilizimit te mbetjeve spitalore te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara per riciklimin e metejshem te tyre.
- Sasia depozituese te mos i kaloje volumet e parashikuara ne menyre qe situata te jete e kontrollueshme dhe te mos demtoje instalimin.
- Te zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri ne menyre qe te perballoje siperfaqen ne rastet e avarive te ndryshme.
- Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes.
- Te mirembahet brezi i pemeve pergjate murit rrethues te prones, ne menyre qe te reduktoje impaktin ne peizazh.

Masat lehtesuese qe do të ndermerren gjate funksionimit te linjes se asgjesimit

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikoje në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga shoqëria për funksionimin e linjes se sterilizimit te mbetjeve spitalore me ane te autoklaves. Ndikimet negative në mjedis gjatë funksionimit te instalimeve janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë permendur në menyrë të përmbledhur si më poshtë:

- Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e linjes se autoklaves.
- Mbetjet e ngurta urbane te paperdorshme që do të prodhohen ne objekt të depozitohen në vëndet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontenier te mjaftueshem për mbetjet për numrin e punonjësve, si dhe riciklimin e tyre nga subjekte te licencuara.
- Menaxhimi sa me eficent i lendes se pare.
- Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti per sterilizimin e mbetjeve spitalore.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.
- Zbatimi i niveleve kufi te zhurmave.

- **ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR;**

Shoqeria GAMASERVICE Sh.p.k disponon kontraten e qirase per pronen ku zhvillohet veprimtaria e cila është i pozicionuar ne L Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK 2679, Numri i pasurise 11/24, Mezez, Kashar, Tirane. Prona ku eshte instaluar sterilizuesi Newster NW10 eshte ekzistuese, e pajisur me leje ndertimi dhe e marre me qira nga shoqeria.

- **MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME);**

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve

Aktiviteti që zhvillon shoqeria "GAMASERVICE", në **Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK 2679, Numri i pasurise 11/24, Mezez, Kashar, Tirane** nga proceset e ndryshme të operimit të punës në objekt në

objekt për asgjesimin e mbetjeve spitalore gjenerohet një sasi mbetjesh sa 25% i volumit total te mbetjeve qe asgjesohen.

- Kerkesat per administrimin e mbetjeve spitalore
  a) Të lejohet hyrja vetëm e personave që kanë kualifikim për të administruar mbetje spitalore.
  b) Të tregohet kujdes për sigurinë e kontejnerëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe/ose të dekompozimit të tyre. Mbetjet njerëzore, shtazore apo të ndonjë gjallese tjetër të magazinuara për më shumë se 24 orë, por gjithsesi më pak se 48 orë nga ambalazhimi, duhet të ruhen në frigorifer ose hapësirë frigoriferike që përdoret vetëm për mbetjet spitalore në një temperaturë jo më të lartë se 10°C.
  c) Të jenë ndërtuar me materiale të qëndrueshme dhe pa kënde, që pastrohen lehtësisht, që nuk lejojnë depërtimin e lëngjeve dhe të jenë rezistentë ndaj parazitëve e agjentëve të tjerë mjedisorë.
  d) Të mbahen pastër në kushte të mira sanitare dhe në gjendje të mirë funksionale.
  e) Mbetjet të jenë të etiketuara në mënyrë të dukshme me simbolin ndërkombëtar të biorrezikshmërisë të paraqitur në shtojcën 2.A dhe me njoftime të rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, frigoriferë dhe kontejnerë të tjerë që tregojnë përdorimin e magazinës për mbetje spitalore, ku hyrja e personave të paautorizuar është e ndaluar.
  f) Sistemet e kullimit të dyshemesë së magazinës duhet të mundësojnë shkarkimet direkt në një sistem kanalizimesh sanitare për asgjësimin e ujërave të ndotura

- Kontejnerët e mbetjeve të rrezikshme spitalore duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të etiketohen në përputhje me shtojcën 2.B dhe të magazinohen në mënyrë të tillë që të lejojnë hyrjen për qëllime inspektimi.
- Mbetjet spitalore nuk duhet të presohen apo t'u nënshtrohen veprimeve të sforcuara mekanike, përveç rasteve kur këto janë pjesë e një procesi të posaçëm trajtimi
- Magazinimi i mbetjeve spitalore. Mbetjet infektive nuk duhet të magazinohen për më shumë se 45 ditë para trajtimit. Në qoftë se era përbën shqetësim publik, Inspektorati Sanitar Shtetëror/Inspektorati i Mjedisit kërkon largim më të shpeshtë. Në zonën e magazinimit të kontejnerëve me mbetje mjekësore duhet të ndalohet hyrja e personave të paautorizuar. Zonat e magazinimit duhet të kenë shenja paralajmëruese në dyert hyrëse, porta ose kapakë. Në zonën e magazinimit nuk duhet të lejohet hyrja e kafshëve dhe elementeve natyrore dhe të parandalohet krijimi i vendeve të shumimit ose burimit të ushqimit për brejtësit ose insektet. Ato, gjithashtu, duhet të jenë të rrethuara.
- Impianti duhet të mbajë regjistrime të pranimeve, që minimalisht përfshijnë informacionin e mëposhtëm:
  a) emrin dhe adresën e prodhuesit;
  b) peshën e mbetjeve të pranuara;
  c) datën dhe orën e pranimit të mbetjeve; dhe
  d) nënshkrimin e personit që pranon mbetjet.
- Të gjitha regjistrimet që bëhen sipas kësaj rregulloreje, ruhen për një periudhë deri në shtatë vjet

KUSHTET QË DUHET TË RESPEKTOJË TRANSPORTIMI I MBETJEVE SPITALORE INFEKTUESE

Përveç automjeteve të urgjencës që kthehen nga vende aksidentesh, çdo automjet që transporton mbetje spitalore infektuese duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjes mjekësore dhe fjalët e përshkruara në shtojcën 2.

Automjetet e përdorura për transportin e mbetjeve spitalore infektuese:

- Duhet të përfshijnë një pjesë ngarkues–transportues, që rri e mbyllur dhe e siguruar përveçse kur ngarkon ose shkarkon mbetje spitalore për të parandaluar hyrjen dhe ekspozimin e paautorizuar ndaj erës dhe reshjeve.
- Duhet të jenë projektuar dhe ndërtuar në mënyre të tillë që të mos lejojë derdhjet;
- Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar pas rrjedhjeve ose derdhjeve aksidentale;
- Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar para përdorimit për ndonjë qëllim tjetër; dhe
- Nuk duhen përdorur për të transportuar ushqime, produkte ushqimore, kontejnerë ushqimorë ose ndonjë substancë, e cila do të gëlltitet nga njerëzit ose kafshët ose do t'i shtohet ushqimeve të njerëzve ose kafshëve.

Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore infektuese, automjetet duhet të mbajnë më vete një kit për ndalimin e derdhjeve dhe për pastrimin e automjetit.

Çdo derdhje prej njëzet (20) ose më shume kilogramësh, duhet të raportohet sa më shpejt që të jetë e mundur te punëdhënësi, Inspektorati Sanitar Shtetëror, Inspektorati Mjedisor, sikurse dhe tek organi kompetent i qeverisjes vendore. Çdo kontakt direkt i mjetit ose pajisjes me mbetjen spitalore duhet të konsiderohet dhe trajtohet si derdhje.

STANDARDE TEKNIKE PËR INCENERIMIN DHE AUTOKLAVIMIN E MBETJEVE SPITALORE

Procesi i sterilizimit nëpërmjet autoklavimit duhet të përfshijë në të njëjtin moment procesin e reduktimit volumor dhe të sterilizimit të mbetjeve spitalore. Sterilizimi duhet të bëhet me avull në temperaturën jo më të vogël se 130°C dhe në presionin jo më të vogël se 1.1 bar.

Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve: Asgjesimi i mbetjeve spitalore ka per synim trajtimin e tyre dhe sterilizimin, duke ulur ndjeshem mundesin e shfaqjes se semundjeve infektive nga keq menaxhimi i ketyre mbetjeve qe gjenerohen nga spitalet.

Menaxhimi i mbetjeve brenda zones së instalimit është tëresisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Rregulloren "Per administrimin e mbetjeve spitalore".

- **MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:**

Programi i Përmirësimit të Procesit të Punës

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit ne sterilizimin e mbetjeve spitalore, mbrojtjen nga gazrat, avujt e ujit, zhurmat, mbetjet, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor "Mbrojtjen e Mjedisit", reduktimin e shkarkimeve, përdorimin e energjisë në mënyrë efiçente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti "GAMASERVICE" Sh.p.k, me përfaqësues ligjor Z. Artan Lleshi ka hartuar "Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës", sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme

Çfarë	*Masat*	*Kush i zbaton*
Parandalim	- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë magazinimit, transportimit dhe përdorimit të teknologjisë. - Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme. - Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik. - Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis. - Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti i sterilizimit te mbetjeve spitalore - Mbajtja gjithmon fikur e automjeteve gjatë procesit të ngarkimit dhe ruajtja e distances së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit që punojne ne impiantin e autoklaves. - Mbajtja e pajisjeve të nevoshjme, nga punonjësit për operimin e punës, si : doreza, këpucë me veshje gome, syze për mbrojtjen e syve, maska kundra pluhurave, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen brenda objektit. - Testimi paraprak i gjithë teknologjisë (instalimeve) dhe rrjetit elektrik. - Pastrimi periodik i vendit të depozitimit të lëndës së parë, pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike te larjes dhe të shiut, si dhe mirëmbatja e pemëve. - Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit dhe impiantit të instaluar. - Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.	Investitori, Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.
Kontroll	- Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike - Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve. - Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave te pstrimit dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti. - Vëzhgimi dhe kulaudimi i vazhdueshëm i të gjithë teknologjisë dhe instalimeve të projektit. - Përdorimi eficenti i energjisë elektrike si dhe sigurimi i ambientit të objektit me ndriçimin e duhur pë zhvillimin e aktivitetit. - Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë. - Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash. - Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës	Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.

	së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.	
Ndërhyrje	- Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike - Mobilizimi i menjëhershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit. - Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparatura nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti. - Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve të pajisjeve/ aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme. - Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar. - Riparimi i menjëhershëm i teknologjisë dhe linjës së sterilizimit, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve. - Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore. - Reduktimi i sasisë së ujrave të përdorura për qëllime sanitare, si dhe në rastet e kontaminimit me mbetje të rrezikshme izolimi i tyre në kontenier të posaçëm dhe të izoluar hermetikisht. - Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt. - Njoftimi i menjehershëm i automjeteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj). - Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim.	Personeli dhe organet Shtetërore të Specializuara.
Administrim	- Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë, zones, instalimeve, infrastrukturës dhe mjeteve të përshkuara më sipër.	

Raportimi i masa të ndërmarra për programin e përmirësimit të operimit

Raportimi i masave që do të ndërmerren në objektin ku ndodhet instalimi për asgjesimin e mbetjeve spitalore me ane te autoklavave Newster NW10, Autostrada Tirane-Durres, Mezez, ZK 2679, Numri i pasurise 11/24, Mezez, Kashar, Tirane, do të kryhet nga shoqëria **"GAMASERVICE"** Sh.p.k, sipas një kalendari dhe regjistri të veçantë, i cili do të plotësohet nga drejtuesi teknik i punës në impiant dhe do të raportohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me miratimin e Përfaqësuesit Ligjor, Z. Artan Lleshi.

Masa të tjera lehtësësuese, për funksionimin eficent dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e asgjesimit te mbetjeve spitalore:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë decorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum perdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.

- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së impiantit te sterilizimit dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulet.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Te behet asgjesimi i sigurte dhe i kontrolluar i mbetjeve spitalore.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruara në ketë Formular-Kërkese për tu paisur me Leje Mjedisi Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhornohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatoreve te mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezulat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimzohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e shkrirjes dhe prodhimit.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eleminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyre e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshem si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficent të energjisë elektrike, kjo do të coj në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianti me eficencë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin për asgjesimin e mbetjeve spitalore vetëm brenda kordinatave të siperfaqes se tokes qe disponon ne pronesi.
- Shfrytëzimi do të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangë në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijim e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin zonave përreth.
- Linja e Impiantit të sterilizimit te mbetjeve spitalore te instaluar në objekt, do të koluaudohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe eficencës që kanë në kryerjen e operacioneve per sterilizimin e mbetjeve spitalore
- Maksimizimi i perdorimit te lendes se pare
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjenike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjeno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të

transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.

- Rrjeti elektrike është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Zona ku do të realizohen operacioni i asgjesimit te mbetjeve spitalore eshte e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së sterilizimit.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksave, etj.
- Eshte ndertuar sistemi i drenazhimit te ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Ndërsa në lidhje në burimet e furnizimit me ujë, jane të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në menyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në impiantin asgjesimit te mbetjeve spitalore.

- **MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për linjen e asgjesimit te mbetjeve spitalore me ane te autoklaves, është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të impiantit.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku jane instaluar linja e autoklaves dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).

- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Shkarkimet e rastit

Ndodhin kur lendet ndotese leshohen ne mjedis ne menyre te paplanifikuar. Keto shkarkime ndodhin kur nuk ka pajisje per kontrollin e tyre. Si ti tille mund te jet nje shkarkim nga mosfunsionimi sic duhet I sistemit te filtrave eshte nje shkarkim afat shkruter dhe menjeher duhet te nderpritet puna per riparimin e difektit.

Shkarkimet aksidentale

Shkaktohen nga difektet ne impiantet industriale, nga gabimet ne manipulimin e pajisjeve. Keto shkarkime shkaktojne ndotje shume te larta, por ato ndodhin shume rralle.

Shkarkimet varen me shume nga menyra e punes se impiantit/instalimit, prandaj rezultati duhet te konsiderohet specifik per menyren e punes se burimit gjate marjes se mostres.

Monitorimi i burimeve te shkarkimeve te lengeta

- Shkarkimet e lengeta mund te mos jene homogjene,ne kete rast duhet kujdes ne zgjedhjen e pikave te marrjes se mostres.
- Te njihet ecuria e procesit teknologjik
- Merren disa mostra pergjate seksionit terthor te tubacionit ose kanalit te shkarkimit
- Zgjidhet nje zone me perzierje te mire
- Depozitimi i lendeve te ngurta ndikon ne mostrat e marra prandaj largesia e pikes se marrjes se mostres te jete 25 fishi i diametrit te tubacionit te shkarkimit
- Nese nuk ka zona me homogjenitet te pershtatshem, mostrat te merren nga disa pika pergjate rrymes
- Kur perberja e mostrave ndryshon me kohen, merret nje seri mostrash ose nje perzierje e tyre.

Objektivi i vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis është të evidentojë vlerat reale të treguesve mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysnisë në ajër, në ujëra të brendshme, në tokë, me qëllim që, në bazë të tyre, subjekti të ndërmarë masa dhe veprime korrigjuese të përshtatëshme dhe të zbatueshme për zonën ku ushtron aktivitetin. Për rastet kur ka ndotje që ndikojnë në situatën e shëndetit publik dhe në mjedis, të përcaktojë shkallën e ndotjes dhe nivelin e devijimit nga normat e lejuar, në mënyrë që programi rehabilitues të hartohet i sakte dhe masat e ndërhyrjes të jenë ato të duhurat dhe në nivelin e duhur.

Në varësi të nivelit të zhvillimit të ndikimit mjedisor, masat që ndërmeren mund të përfshijnë ndalimin/eliminimin e shkakut të ndikimit, ose mund të jenë të karakterit zbutës e reduktues.

Zgjidhja më e mirë, kur rrethanat e lejojnë, është ndalimi/eliminimi i ndotjes dhe shkaqeve të tjera.

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis.

Subjekti merr përsipër sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit.

Subjekti, gjithashtu, do të ketë lidhje të vazhdueshme me Agjensinë Kombetare të Mjedisit, pranë të cilës do të informojë periodikisht për mbarvajtjen e punës si gjatë sterilizimit te mbetjeve spitalore ashtu dhe për monitorimin e parametrave të mësipër.

Monitorimi dhe rekomandime

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore.

Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse.

Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si AKM-ja,dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit etj.

PLANI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS.

EMËRTIMI	MASA	PËRGJEGJËSIA	SHËNIME
Shkarkime në ajër te avujve te ujit	Monitorim i vazhduar do të kryhet për parametrat në vijim: lënda e ngurtë (pluhurat), presioni, temperatura e avujve te ujit. Qëllimi këtij monitorimi do të jetë që GAMASERVICE të kontrollojë ecurinë e procesit dhe funksionimin e pajisjeve të kapjes së avujve. Raportimi 3 mujor për përmbajtjen në shkarkimet e avujve te ujit. Të gjitha pajisjet e përdorura për monitorimin e vazhduar të jenë objekt i mirëmbajtjes dhe kalibrimit rutinë në përputhje me instruksionin e prodhuesit.	GAMASERVICE	Frekuenca dhe metodika në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar për mjedisin dhe udhëzimet e institucioneve të huaja botërore për këtë qëllim Të raportohet menjëherë në rast shmangie nga kufijtë ligjor dhe praktika më e mirë.
Mbetje	Për të gjithë flukset e mbetjeve (të ngurta dhe të lëngëta) duhet të mbahen të dhëna për: – Sasinë e mbetjeve; – Formën fizike; – Mënyrën e depozitimit/trajtimit; – Pikën e depozitimit përfundimtar; – Sasinë e asgjesuar	GAMASERVICE	Të dhënat e monitorimit dhe gjendja e përputhjes së tyre me këtë Plan Monitorimi në Mjedis do të raportohen.

Ujëra të ndotur	Ujërat e shkarkimit në dalje të objektit do të kontrollohen (monitorohen) në mënyrë periodike për të demonstruar përputhjen me legjislacionin. Inspektime të rregullta të ujërave të shkarkuara në kanalin kryesor të zones.	GAMASERVICE	Shpeshtësia dhe metodikat do të përmbushnin kërkesat e legjislacionit shqiptar të mjedisit

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron zbatimi i këtij projekti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të projektit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm eshte bëre konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Monitorimi i parametrave mjedisore

Nr.	**Monitorimi**	**Parametrat që do të monitorohen**	**Periudha kohore**	**Frekuenca**	**Përgjegjësia**
1	**Cilësia e Ajrit**	PM10, O2, CO	Vendosja ne funksionim te instalimeve 2021	Çdo 3 muaj	Eksperti Mjedisor Laborator i akreditуar
2	**Emetimi i zhurmave**	Niveli i zhurmave në dB	Vendosja ne funksionim te instalimeve 2021	Çdo 3 muaj	Eksperti Mjedisor Laborator i akreditуar
3	**Rastet, incidentet e mundshme në vendin e punës**	Regjistrimi dhe raportimi i mënyrës së trajtimit	Vendosja ne funksionim te instalimeve 2021	Çdo 3 muaj	Oficeri i Sigurisë
4	**Avari apo defekte të ndryshme të mundshme gjatë operimit**	Regjistrohen, raportohen	Vendosja ne funksionim te instalimeve 2021	Çdo 3 muaj	Oficeri i Sigurisë dhe Drejtuesi i Punimeve
5	**Monitorim i zbatimit të kushteve të Lejes Mjedisore**	Monitorohen, regjistrohen, raportohen	Vendosja ne funksionim te instalimeve 2021	Çdo 6 muaj	Eksperti i Mjedisit & Inspektoriati përkatës

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlërësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë"
Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit dhe në rast të kundert, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre ose gjashte muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto, masat e marra per reduktimin e ndotjes ne mjedis dhe menyren e zbatimit te kushteve te lejes mjedisore.

Regjistimi i të dhënave mjedisore

Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçantë ku do të pasqyrohen të gjitha parametrat e monitoruar nga shoqëria **"GAMASERVICE" Sh.p.k,** mirëmbajtja dhe përditësimin e regjistrit nga drejtuesi teknik i instalimit.

f. KONSULTIMET NDERKUFITARE

Zona ku zhvillohet do te zhvillohet aktiviteti nuk ka nevoje ti nenshtrohet procesit te konsultimit nderkufitar.

g. AUTORITETI VENDIMARRES PER DHENIEN E AKTIT TE MIRATIMIT TE LEJES SE MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QE NDIQEN.

Autoriteti miratues eshte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos per miratimin apo refuzimin e aplikimit per tu pajisur me leje mjedisit te tipi B, me propozim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacion e paraqitur nepermjet Qendres Kombetare te Biznesit.

Afati per marrjen ne shqyrtim te aplikimit per pajisjen me leje mjedisit te tipit B eshte 40 dite pune.

h. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TE DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NE FORME ELEKTRONIKE, BRENDA 20 DITE NGA DATA E NJOFTIMIT.

Faqja zyrtare e Agjencise Kombetare te Mjedisit: akm.gov.al